



**Komisioni i
Pavarur i
Kualifikimit**

NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ZNJ. MERITA SELIMI

□ □ □

27/07/2023

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 25.7.2023, për subjektin e rivlerësimit, znj. Merita Selimi bazuar në ligjin nr. 84/2016, me shumicë votash vendosi:

Shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnje.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Brunilda Bekteshi, z.Lulzim Hamitaj relator, znj. Etleda Çiftja anëtare, do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

Ky vendim u shpall sot, në datën 27.7.2023.